



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr.23, datë 17.12.2021

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin Dhjetor, që zhvillohet me mjete të komunikimit elektronik (aplikacioni SKYPE).

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:04

Data e mbajtjes së mbledhjes : 17.12.2021

Mbajtja e mbledhjes : Online aplikacioni SKYPE

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Rradhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari Gentian Kallmi dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur dokumentacionin për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi : Të nderuar Këshilltarë ! I nderuar Zëvendëskryetar!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë rradhe të Këshillit Bashkiak Durrës me mjete të komunikimit elektronik. Kjo mbledhje është kërkuar nga Kryetarja e Bashkisë. Siç jeni në dijeni materialet Ju janë vënë në dispozicion nga Sekretarja e Këshillit.

Ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj dhe prezencën online.

Dorina Milja: Përshëndetje ! Fillojmë me prezencën. Jolanda Mustafaraj prezent.... deri te Morena Bojame email.....

Kryetar kemi 26 këshilltarë, që u dëgjuan online dhe 11 vota me email.

(p.s....u dëgjuan gjatë apelit 26 këshilltarë, hyn pak me vonesë J.Zaza dhe I.Cërloj, pra 28 këshilltarë online, dhe 11 këshilltarë kanë votuar me email).

Ani Dyrmishi: Meqë kuorumi është i pranishëm kalojmë në rendin e ditës dhe miratimin e tij.

Siç të gjithë jemi njoftuar me email sot kemi vetëm 1 pikë për rendin e ditës , e cila është :

1. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE SHITESË TË ALOKUARA NGA BUXHETI I SHTETIT NË ZBATIM TË AKTIT NORMATIV NR. 34, DATË 3.12.2021 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 137/2020 “PËR BUXHETIN E VITIT 2021”, TË NDRYSHUAR
---	---

Përsa i përket rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana këshilltarëve ? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?(ndërkohë qetësi, po votohet në chat).

Ju lutem votoni

Kundra?Apstenim?.... Ju lutem kush nuk ka votuar ende të votojë.

Valentino Mustaka : Ani, jam pro rendit të ditës.

Ani Dyrmishi : Po Valentin...

Atëherë kush nuk ka votuar, ju lutem të votojë. Eni, të lutem më konfirmon nëse procesi i votimit është në vijim apo është mbyllur.

Eneida Marku (asistenca teknike) : Kolegët kanë votuar pro rendin e ditës.

Ani Dyrmishi : Atëherë me shumicë votash miatohet dhe rendi i ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 1** e të vetme të rendit të ditës, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

Alneida Roshi : Përshëndetje Kryetar !

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike për miratimin e përdorimit të detajimit të fondit të përfituar në formën e transfertës së pakushtëzuar propozon në mënyrë unanime për ta kaluar. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderi znj.Roshi. I japim fjalën Komisionit Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave, Z. Valentino Mustaka.

Valentino Mustaka: Edhe Komisioni Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin e përgatitur nga drejtoritë përkatëse në mënyrë unanime është dakort të miratohet pika 1.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z. Mustaka!

Atëherë komente përsa i përket kësaj pike kemi nga ana e këshilltarëve ?.....

Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim .

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Kundra? Apstenim?.....

Ju lutem Jurgenit dhe Indritit po votojmë për pikën 1.

Atëherë, kush nuk ka votuar ende të votojë....

Eni të lutem ma konfirmon, është mbyll procesi?

Eneida Marku (asistenca teknike) : 2 kolegët që sapo thirrët është e nevojshme të konfirmojnë votimin për pikën 1.

Ani Dyrmishi : Atëherë Jurgen Zaza, Indrit Cërloj.....

Eneida Marku (asistenca teknike) : Po.

Ani Dyrmishi : Atëherë Eni, ndoshta nuk janë lidhur këshilltarët....(qetësi pritët të votojnë)
Mbyllet procesi i votimit.

Me 28 vota pro dhe 11 me email , 39, miratohet pika 1 dhe e vetme e rendit të ditës.

Nëse ka diçka për të shtuar Zëvendëskryetari?

Gentian Kallmi : Jo, faleminderit

Ani Dyrmishi: Faleminderit. Ju falenderoj të gjithë pjesmarrësve, Këshilltarët, Zëvendëskryetarin. Për mbledhjen e rradhës do njoftoheni siç jeni njoftuar me email, do njoftoheni dhe për pikat e rendit të ditës. Ju falenderoj të gjithëve. Kalofshi një fundjavë të mbarë dhe mbledhjen e deklaroj të mbyllur

Ky procesvebal mbyllet me nr.rendor 3(tre) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :	ANI DYRMISHI
Sekretare e Këshillit Bashkiak :	DORINA MILJA
Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :	ELIO JANI
Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :	ETLEVA VELÇANI (përfaqësuar nga FLUTURA KASA)